

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga Shkëlqim Berisha - Nga copëtimi te kriminalizmi/ Një shekull narrativë ndaj shqiptarëve
ADRESA	https://www.syri.net/analize/919262/nga-copetimi-te-kriminalizmi-nje-shekull-narrative-n-daj-shqiptareve/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 07:48:36 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 07:18:20 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3e0217f111fbc3b857029b53ef124abbbc9b7afd3659b84473b7a79450d0cea2
TEKSTI	86b019d1764795d60da527bc22849d3046e5feb2cc07027f66395b3c7b7aefd8
PAMJA	2abf550719cae08ffffee604ba3a96c306486de70043b8696720b984f0ccbb0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	35847eeee0c9b609de774c322ccfa8da28729c41e728fdc564261f350c0f173a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c5ef72e280ad02d10fcef52ca02446c3f1a387185640f8c3107dbc4e00e7b78
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/35847eeee0c9b609de774c322ccfa8da28729c41e728fdc564261f350c0f173a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**NDRIÇIM KULLA**

Dorëheqja urgjente e Edi Ramës nuk është më vetëm një kërkesë e opozitës, por edhe e ndërkombëtareve

**ENVER BYTYÇI**

Vendimi i Hagës dhe raporti ynë me të vërtetën!

**më të lexuarat**

Nga lindja në perëndim: Pse Turqia po luan në të dyja anët

Putini vë në provë shpresat e Trump-it për një marrëdhënie të re me Rusinë

Jo revoltë kundër Merzit, por shumë pakënaqësi në prapaskenë

Miqësi, ndryshim kursi dhe akuza: Si e sheh Evropa Izraelin

Nga copëtimi te kriminalizmi/ Një shekull narrativë ndaj shqiptarëve

Rritja e çmimeve, zemërimi i votuesve në Francë: Si mund ta formësojë kriza e karburantit fushatën presidenciale



Nga copëtimi te kriminalizmi/ Një shekull narrativë ndaj shqiptarëve

09:18, 26/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Nga Shkëlqim Berisha

Për më shumë se një shekull, shqiptarët janë përballur me një narrativë që i paraqet si popull të dhunshëm, të prirur drejt kriminalitetit dhe të paaftë për të ndërtuar shtet.

Kjo nuk ishte vetëm një fyerje kulturore. Ajo u përdor si instrument politik për të kundërshtuar bashkimin e trojeve shqiptare dhe për të arsytuar vendimet që lanë jashtë kufijve të Shqipërisë një pjesë të madhe të popullsisë shqiptare.

Copëtimi i trojeve shqiptare nuk erdhi vetëm prej kësaj propagande. Ai ishte rezultat i interesave të Fuqive të Mëdha, pushtimeve ushtarake dhe ambicieve territoriale të shteteve fqinje. Por portretizimi i shqiptarëve si një popull "pa aftësi shtetformuese" ndihmoi që padrejtësia të paraqitej si një zgjidhje e pranueshme diplomatike.

Kur një narrativë përsëritet për më shumë se një shekull dhe prodhon pasoja diplomatike, territoriale e institucionale, ajo pushon së qeni vetëm paragjykim dhe shndërrohet në projekt politik.

Sot, kjo narrativë duket se ka arritur një nga pikat e saj më të larta. Ajo nuk shfaqet më me gjuhën e vjetër të fillimshkullit XX. Tani përdor fjalët: korrupsion, krim i organizuar, shtet i kapur dhe elitë e kriminalizuar.

KOSOVA. NGA ALEATËT E LUFTËS TE TË AKUZUARIT E PAQES

Kosova është shembulli më i dhimbshëm i këtij transformimi.

Gjatë luftës, udhëheqësit e UÇK-së u pranuan si partnerë të Perëndimit. Ata morën pjesë në Rambuje, bashkëpunuan me NATO-n dhe drejtuan procesin politik që çoi në shpalljen e pavarësisë.

Për vite të tëra, këta njerëz u pritën në Uashington dhe në kryeqytetet europiane

si përfundues regjime të Kosovës. Me pas, nën detyrë të fuqisë
ndërkombëtare, vetë Kosova u detyrua të krijonte një gjykatë të posaçme, të
lidhur kryesisht me pretendimet ndaj ish-pjesëtarëve të UÇK-së.

Formalisht u gjykuan individë. Politikisht, në bankën e të akuzuarve u vendos
pothuajse e gjithë udhëheqja historike e luftës dhe e shtetformimit të Kosovës.

Serbia ishte shteti që zhvilloi luftën dhe aparati i saj shtetëror kreu dhunën
kryesore ndaj shqiptarëve. Megjithatë, sot është udhëheqja shqiptare e
rezistencës ajo që shfaqet në mënyrë të përqendruar përpara drejtësisë
ndërkombëtare.

Kjo nuk e mohan përgjegjësinë individuale për çdo krim të provuar. Por ngre një
pyetje të pashmangshme: përse drejtësia ndaj shqiptarëve u institucionalizua në
një mekanizëm të posaçëm, ndërsa përgjegjësia shtetërore dhe politike e Serbisë
nuk prodhoi një proces të ngjashëm bashkëkohor ndaj elitës që trashëgoi atë
sistem?

SHQIPËRIA. NGA TOLERIMI TE KRIMINALIZIMI

Në Shqipëri, fenomeni mori një formë tjetër.

Për vite me radhë, qeveria shqiptare u trajtua si garantuese e stabilitetit, integritetit
europian dhe orientimit properëndimor. Në emër të këtyre prioritetëve u toleruan
përqendrimi i pushtetit, dobësimi i institucioneve, klientelizmi dhe lidhjet gjithnjë e
më të dyshimta ndërmjet politikës dhe interesave ekonomike.

Ndërkombëtarët nuk i detyruan politikanët shqiptarë të kryenin shkelje. Por
toleranca e tyre ndihmoi në krijimin e një mjedisi ku mungonin kufijtë, kontrolli dhe
përgjegjësia.

Sot shohim ish-zëvendëskryeministra, ministra, drejtues institucionesh, kryetarë
bashkish dhe njerëz të konsideruar si pasardhës të mundshëm politikë të
përfshirë në procese penale.

Modeli është gjithnjë i njëjti: zëvendëskryeministra, drejtues të shërbimeve
sekrete, kryebashkiakë, ministra, të gjithë kalojnë përpara drejtësisë; disa
dënohen, disa arratisen. Drejtësia zbret deri aty ku fillon pushteti qendror dhe
ndalet pikërisht atje.

Drejtësia duhet ta bëjë detyrën e saj. Por pyetja mbetet: ku ishin partnerët
ndërkombëtarë kur ky sistem po ndërtohej? Përse për kaq shumë vite stabiliteti i
një qeverie u vlerësua më shumë sesa shëndeti i institucioneve shqiptare?

Fillimisht u tolerua deformimi. Sot po ndëshkohet pasoja. Ndërsa përgjegjësia për
gjithçka po u mbetet vetëm shqiptarëve.

Kjo nuk është thjesht debat abstrakt drejtësie. Është edhe arsye pse gati një e
treta e shqiptarëve ka braktisur vendin pa ndodhur luftë, jo vetëm për shkak të
varfërisë, por edhe për shkak të rraskapitjes qytetare: shpresa se sistemi
ndryshon u zëvendësua nga bindja se vetëm ftyrat ndryshojnë.

SERBIA. SHTETI QË DUHET MBAJTUR PRANË

Serbia ka korrupsion, kapje të institucioneve, presion mbi mediat dhe lidhje të
politikës me struktura të dyshimta. Megjithatë, ajo nuk po përjeton të njëjtin
çmontim të elitës politike.

Shembulli më domethënës i këtij standardi është vetë Aleksandar Vuçiçi. Gjatë
luftës së Kosovës, ai ishte ministër i Informacionit në qeverinë serbe nën regjimin
e Slobodan Millosheviçit, në një periudhë kur mediat e pavarura censuroheshin
dhe propaganda shtetërore shoqëronte dhunën e aparatit serb. Megjithatë, kjo
trashëgimi politike nuk e pengoi të riciklohej fillimisht si reformator, më pas si
kryeministër e president dhe, në fund, si bashkëbiseduesi i domosdoshëm i
Perëndimit.

Kontrasti është i fortë: udhëheqësit e UÇK-së kaluan nga partnerë të Perëndimit
në të akuzuar dhe të dënuar në Hagë, ndërsa një ministër i sistemit të
Millosheviçit kaloi nga zëdhënës i propagandës së luftës në garantues të
stabilitetit rajonal.

Beogradi vazhdon të trajtohet si qendra e domosdoshme e rajonit: shteti pa të cilin
nuk mund të diskutohet për Kosovën, Bosnjën, Malin e Zi, Rusinë, Kinën apo
sigurinë ballkanike.

Fuqia e Serbisë për të prodhuar destabilitet është kthyer në kapital diplomatik.
Prandaj asaj i kërkohet bashkëpunim, ndërsa shqiptarëve u kërkohet vazhdimisht
të provojnë aftësinë e tyre për të ndërtuar shtet.

Ndërsa Gjykata e Posaçme në Kosovë dhe strukturat antikorrupsion në Shqipëri
thithin energjinë politike të dy shteteve shqiptare drejt pastrimit të vet të

brendshëm, asnjëra prej tyre nuk mbetet me kapacitet apo legjitimitet për të vepruar si zë koordinues rajonal për çështjen shqiptare në tërësi. Serbisë nuk i duhet të bëjë asgjë për këtë rezultat, i mjafton që fqinjët e saj të mbeten të zënë me veten.

Edhe kur Vuçiqi largohet nga Presidenca, ai mund të rikthehet si kryeministër. Ndryshon posti, por jo domosdoshmërisht sistemi. Në Serbi elita riciklohet; në Shqipëri dhe Kosovë ajo çmontohet dhe vendoset në bankën e të akuzuarve.

Kështu krijohet një standard i dukshëm:

Në Kosovë kriminalizohet brezi i shtetformimit. Në Shqipëri goditet njëra pas tjetrës elita qeverisëse. Në Serbi pushteti riciklohet dhe shteti ruan rolin e partnerit të domosdoshëm.

Kjo nuk do të thotë se duhet të mbrojmë korrupsionin, krimin apo cilindo politikan shqiptar. Përgjegjësia individuale duhet të ekzistojë dhe drejtësia duhet të veprojë.

Por përgjegjësia duhet të jetë personale, e barabartë dhe e mbështetur mbi të njëjtin standard, jo të shndërrohet në një akuzë kolektive ndaj shqiptarëve.

Dikur narrativa se shqiptarët nuk dinin të bënin shtet ndihmoi në legjitimimin e copëtimit të trojeve të tyre. Sot, kriminalizimi i elitave shqiptare rrezikon të përdoret për të vënë në dyshim aftësinë e dy hapësirave politike shqiptare për të qenë zotër të së ardhmes së tyre.

Shqiptarët po paguajnë edhe për gabimet e udhëheqësve të tyre, edhe për tolerancën shumëvjeçare të atyre që i mbështetën dhe mbyllën sytë.

Serbia, ndërkohë, vazhdon të shpërblehet për peshën dhe aftësinë e saj për të kërcënuar stabilitetin.

Ky projekt kundër shqiptarëve duhet të marrë fund me çdo çmim, me vetëdije kombëtare, bashkim, shtet ligjor, diplomaci dhe fuqinë e argumentit. Dhe duhet të mbyllet nga vetë shqiptarët, sepse askush tjetër nuk do ta bëjë për ta.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Nga lindja në perëndim: Pse Turqia po luan në të dyja anët



Miqësi, ndryshim kursi dhe akuza: Si e sheh Evropa Izraelin



Ferri pas hekurave: Burgjet e Italisë kthehen në furra


TË NGJASHME



Jo revoltë kundër Merzit, por shumë pakënaqësi në prapaskenë



Putini vë në provë shpresat e Trump-it për një marrëdhënie të re me Rusinë



A po lind pas Hagës një kauzë e re shqiptare?



Studentët janë peng i ekraneve, po humbasin aftësinë për t'u shkëputur dhe për t'u përqendruar



Izraeli kishte dy detyra pas 7 tetorit. Dështoi në njërin prej tyre dhe humbi narrativën



Nga UÇK-ja te UÇD-ja: Beteja e re e Kosovës është Diplomatie



Groenlanda, Danimarka, SHBA - Arrihet marrëveshja për ishullin Arktik, besimi tronditet



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.